

Dr. sc. Fahredin SHABANI

DERVISH HIMA - PUBLICIST DHE VEPRIMTAR I SHQUAR I RILINDJES KOMBËTARE

Vitet '90 të shekullit XIX cilësohen për një vetëdijësim të shqiptarëve dhe të Lëvizjes së tyre Kombëtare, drejt radikalizimit të kërkesave, fillimisht për autonomi, dhe më pastaj për shpëtim të plotë nga Porta. Krejt ky aktivitet i Rilindjes Kombëtare Shqiptare ndërlihet njëkohësisht me intensifikimin e propagandës së monarkive ballkanike, para se gjithash të Serbisë e të Greqisë, e drejtuar kundër ekzistencës së popullit shqiptar. Ishte, po ashtu, koha kur propaganda kishtarë bullgare, serbe e greke, përmes emërimit të kuadrit të tyre kishtarë sinonim asimilimin e plotë të shqiptarëve të krishterë ortodoksë. Kështu, në vitin 1895 qeveria e Sofjes kërkoi nga Stambolli emërimin e pesë peshkopëve bullgarë në viset shqiptare e ato maqedonase, por që kjo kërkesë nuk u mor parasysh nga kryeministri i atëhershëm, Sait Pasha. Ndërsa në vitin 1896 Serbia shkëputi nga Porta urdhëresën për emërimin e një mitropoliti serb në Prizren, për të cilin po punonte prej kohësh. Nisur nga kjo, në janar të vitit 1897 Stambolli caktoi një administrator serb në Dioqezën e Shkupit, që Beogradi zyrtar synonte ta vinte nën kontrollin e kishës së vet.

Rritja e ndikimit të kishave bullgare e serbe në viset shqiptare, hapja më 1890 e një shkolle bullgare në Korçë, si edhe orvatjet e reja për t'i futur dioqezat e krahinave lindore shqiptare nën varësinë e Ekzarkatit, dhe ato të Kosovës nën varësinë e kishës serbe, e për t'i paraqitur ato si sllave, i motivoi rilindësit që, krahas qëndresës kundër Patrikanës greke të Stambollit, të luftonin edhe kundër ekspansionit bullgar e serb në planin kishtar.

Në rrethana të tilla, Lëvizja Kombëtare Shqiptare hodhi përsëri idenë e shfaqur që prej kohësh, atë të krijimit të një kisha shqiptare të pavarur nga Patrikana e Stambollit, si mjet ky që do t'i jepte fund ndikimit të qarqeve shoviniste fqinje në ushtrimin e trysnisë mbi popullsinë ortodokse shqiptare, me anë të kishës së tyre.

Sigurisht që krijimi i një Kisha ortodokse kombëtare, do t' u hiqte mundësinë fqinjëve ta përdorin atë dhe klerin e lartë ortodoks si një mjet politik për të përmbushur lakmitë e tyre pushtuese në viset e banuara me shqiptarë. Nisur nga kjo, prandaj, përfaqësuesit më të spikatur të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, do të dalin me kërkesa shumë më të avancuara rreth realizimit të një autonomie territoriale-administrative, por edhe kishtarë të Shqipërisë, si një zgjidhje më e drejtë e çështjes shqiptare, në kushtet ekzistuese të atëhershme.

Është koha kur shqiptarët i kishte kapluar mjerimi i madh ekonomik që mund të thellohej edhe më tepër me politikën "premtuese" të zbatimit të reformave. Mbase e gjithë kjo kishte kontribuar që shqiptarët të organizonin rezistencën kundër po këtyre reformave me karakter demagogjik në vilajetin e Shkodrës, në një pjesë të vilajetit të Kosovës dhe në Shqipëri të Jugut. Është, po ashtu, koha kur komisioni i inspektimit të reformave të Rumelisë, i cili gjatë majit të vitit 1896 ndodhej në Vilajetin e Manastirit, do të përballlet me një promemorie të drejtuar kundër politikës antishqiptare të Portës.

Autor i kësaj promemorieje ishte një shqiptar i ri nga Starova afër Ohrit, Ibrahim Naxhiu, i cili më vonë në historinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, do të njihet me emrin Dervish Hima. Fillimisht, si autor i kësaj promemorieje, ai do të nënshkruhet si "një dashamirës i atdheut".² Promemoria ndërkaq përbënte një sintezë pikëpamjesh të autorit lidhur me gjendjen e brendshme dhe ndërkombëtare të Shqipërisë, me të tashmen dhe me të ardhmen e saj. Aty përcaktoheshin masat që duheshin marrë në atë kohë për shpëtimin e vendit nga rreziku i copëtimit dhe për ta futur atë në rrugën e përparimit e të qytetërimit. Me hartimin e saj ai i dha Rilindjes Kombëtare Shqiptare një dokument programatik tepër të rëndësishëm, ku shprehej qëndrimi i shqiptarëve kundër reformave osmane të prillit të vitit 1896.

Promemoria iu imponua D. Himës si pasojë e rrethanave historike të kohës, si dhe nga gjendja e ndërlikuar ndërkombëtare, që u krijua për Shqipërinë në mesin e viteve '90-të kur, si pasojë e acarimit të çështjes maqedonase, doli në plan të parë, me gjithë forcën e saj, lufta për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë.

Dervish Hima përshkruan me shprehjet më të fuqishme,

me ndjenja të thella të atdhedashurisë dhe me shqetësimin e ligjshëm për fatin e popullit shqiptar gjendjen e brendshme e atë ndërkombëtare të Shqipërisë. Ai shfaqet këtu si një publicist i talentuar dhe njohës i mirë raportesh të forcave në arenën ndërkombëtare, e veçanërisht në Ballkan. Atë e shqetësonte pozita e Shqipërisë, rreziqet që e kërcënonin në atë kostelacion forcash të vendosur në Ballkan dhe në Evropë. "Populli ynë i ndershëm, i pafajshëm dhe fukara po pëson vuajtje e skamje të mëdha dhe më në fund po bëhet pre e shteteve të huaja. Çfarë pandërgjegjshmëri e madhe!". Shqipëria, për shkak të pozitës së rëndësishme gjeografike, të pasurive të shumta dhe pjellorisë së tokës së saj, lakmohet nga shtetet e huaja, që i kanë ngulur sytë dhe po përpiqen të gëlltisin pjesë-pjesë trupin e saj",³ shkruante ai, që atëherë.

Vetë D. Hima ishte përkrahës i autonomisë së Shqipërisë. Ai, në fakt, mendonte që në fillim se Shqipëria mund të vendoste afërsisht marrëdhënie të tilla me Portën, si Hungaria me Austrinë, por me një ndryshim thelbësor, me kusht të funksionimit të një administrate të veçantë për të gjitha çështjet, të shkëputura nga pushteti perandorak. Kjo tregon se zgjidhjen e çështjes shqiptare ai nuk e shihte në kthimin e Portës në një shtet dualist osmano-shqiptar të ngjashëm me Austro-Hungarinë. Ky rilindës i devotshëm kërkonte thjesht formimin e një shteti shqiptar me një autonomi të gjerë. Lidhjet e Shqipërisë autonome me Perandorinë Osmane i shihte vetëm në lëmin ushtarak. Edhe këtu, ato do të bashkëvepronin vetëm kur ishte e nevojshme.⁴

Sikurse pritej, Komisioni i reformave nuk mori parasysh promemorian e Dervish Himës. Po ky, më 20 maj (1 qershor) 1896, shkruante se nuk doli ndonjë rezultat, se ata të Komisionit nuk kanë marrë ndonjë masë, duke i bërë të ditur Ibrahim Temos se nuk do të ishte keq që promemoria t'u dërgohej gazetave xhonturke "Meshveret" ose "Mizan" ("Peshorja", Kajro).

Por Promemoria nuk ishte i vetmi dokument që iu shpërnda administratës osmane dhe shteteve të Evropës më 1896. Të shumta ishin letrat e telegramet që iu dërguan atyre nga Shqipëria. Për to bëhet fjalë edhe në promemorie. Madje D. Hima, në një thirrje që do t'u drejtonte më vonë bashkatdhetarëve të vet, kujtoi përsëri kërkesat, të cilat iu dërguan Portës më 1896, duke theksuar se

këto nuk u pranuan nga Sulltani. Ai përmendte edhe peticionet e nëntorit të 1896-ës. "A nuk ju kujtohet, shkruante ai, se si u mbloodhët në nëntor të 1896-ës dhe i dërguat Padishahut lutjet për të qarë hallet tuaja? Nuk u plotësuan as këto. Edhe unë isha atëherë midis jush" .5 Siç shihet, peticionet e vitit 1896 ishin të shumta. Njihet sot gjithashtu, thoshte ai, edhe memorandumimi dërguar Kryeministrit të Perandorisë Osmane me titull: "Në emër të popullit shqiptar", hartuar nga I. Temoja, N. Naço etj., në korrik të vitit 1896, si dhe memorandumimi drejtuar qeverive të shteteve të Evropës nga shqiptarët e Kolonisë të Sofjes, më 18 shtator 1896.⁶

D. Hima gjeti në Rumani një terren të përshtatshëm për propagandimin e ideve kombëtare, të përgatitura nga veprimtarët e shoqërive të Bukureshtit. Këtu qe vendosur, pas arratisjes nga Stambolli, edhe miku i tij më i ngushtë dr. Temo, i cili dha një kontribut të madh në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe u shqua si "një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm dhe më të palodhur të propagandës shqiptare jashtë atdheut".⁷ Në Bukuresht Hima u bashkua me grupin e veprimtarëve më të rinj që ishte formuar atje, i cili përbëhej nga Nikolla Naço, Ibrahim Temo, Jani Mihal Jehova, Kristo Luarasi, Jashar Erebara, Kost Jani Trebicka, Adam Shkaba dhe atdhetarë të tjerë. Ky grup formoi edhe Komitetin Shqiptar⁸ me qendër në Bukuresht, i cili bëhet ndër përhapësit e zjarrit të ideve për çlirim kombëtar.

Në kryeqendrën e Rumanisë, Dervish Hima dallohet si publicist i talentuar. Në gusht të vitit 1897 botoi në organin "Shqipëria" të Bukureshtit shkrimin "Një kartë", ku polemizonte me gazetën "Revy d'Orient" (Revue d'Orient), që e quante Lëvizjen Kombëtare Shqiptare si vepër të shqiptarëve të krishterë dhe përjashtonte prej saj shqiptarët muslimanë, për të cilët thoshte se "I qëndronin besnik qeverisë turke". Duke i konsideruar pohimet e tilla "si pjellë e një pene të verbër e të mashtruar", D. Hima theksonte se shqiptarët muslimanë dhe ata të krishterë kanë luftuar dhe vazhdojnë edhe sot të luftojnë bashkërisht kundër zgjedhës osmane, "për lirinë dhe autonominë e Shqipërisë". "Feja në mes të shqiptarëve, shkruante ai, as ka sjellë, as nuk sjell ndonjë ndalim për punën e kombit. Sot, shqiptarët, të krishterë dhe muhamedanë, si vëllezër që janë, u pushtuan vëllazërisht dhe punojnë tok për të drejtat e tyre, për lirinë e tyre, për të këputur ata të këqij zinxhirë të robërisë së turkut..."⁹

vinte në dukje ai.

Në mërgim D. Hima mbeti ndër organizatorët më të dalluar të Lëvizjes Kombëtare i veçuar si veprimtar konsekuent i Kolonisë shqiptare të Bukureshtit. Dha një ndihmesë të veçantë në përgatitjen dhe në organizimin e Kongresit Shqiptar që u mbajt në Bukuresht, më 13 nëntor 1898, ku si folës u paraqitën V. Dodani, F. Konica, J. Meksi, M. Toptani, D. Hima etj. Ky i fundit mbajti një fjalim, të cilin bashkëkohësit e quajtën “tepër të rëndësishëm” e që tërhoqi vëmendjen e gazetarëve të huaj, të pranishëm në Kongres. Fjala e tij reflektonte për gjendjen e mjerueshme të Shqipërisë e, në mënyrë të veçantë, të sistemit shkollor, që dallohej për një prapambeturi të thellë. Provoi me argumente bindëse domosdonë për ta bindur opinionin publik ndërkombëtar se kombi shqiptar, si të gjitha kombet e tjera, duhej të kishte shkollat e veta kombëtare, të cilat do ta ndihmonin të hynte në rrugën e qytetërimit.¹⁰ Në emër të dy mijë shqiptarëve, që morën pjesë në Kongres, do t’i dërgohet një telegram Sulltanit, në të cilin kërkohej futja e gjuhës shqipe në të gjitha shkollat e Shqipërisë dhe të mbahej për këtë qëllim 1/6 e taksave, që mblidheshin në vend. Në Shqipëri, thuhej në telegram, ka vetëm dy shkolla shqipe në mesin e 5 mijë shkollave në gjuhë të huaj.¹¹

Deri në vitin 1902 Dervish Hima do t’i dhuronte Rilindjes Kombëtare një nxitje të madhe në rritjen, zhvillimin dhe intensifikimin e luftës së shqiptarëve për autonomi. Ai ishte në dijeni të punimeve të Kuvendit të Lidhjes së Pejës të vitit 1899, si dhe për Lidhjen Shqiptare të Pejës dhe do të shkruante një broshurë në turqishte me titull “Të zgjohemi”. Më pastaj, ai do të jetë një propagandues i zjarrtë i çështjes shqiptare në Evropë, si në Romë ashtu edhe në Bukuresht, ndërsa përvojën prej një atdhetari të zjarrtë dhe pajisjen me ide të reja demokratike kombëtare do t’i fitojë gjatë kontakteve e bisedave të drejtpërdrejta me Ismail Qemalin në Egjiptin e largët, gjatë marsit të vitit 1900.

Padyshim se karrierën e pasur prej një mendimtari shembullor politik, Dervish Hima do ta ndërtojë gjatë vitit 1902 e tutje kur, në cilësinë e delegatit, merr pjesë në Kongresin xhonturk të Parisit. Në Kongres ishte ftuar edhe Ibrahim Temo, por Dervishi i rekomandoi atij të mos shkonte. “Kjo do të jetë një punë boshe”, i shkruante ai Temos, në fillim të tetorit të 1901-it.

Duke konvokuar Kongresin, xhonturqit synonin të forconin unitetin e partisë së tyre "Bashkim e Përparim", bashkimin e të gjitha forcave e rrymave, të cilat merrnin pjesë në luftë, kundër absolutizmit të Sulltanit. Kujdes të veçantë patën ata për të tërhequr në Kongres e në lëvizjen e tyre veprimtarët më me ndikim nga popujt e tjerë të nënshtruar të Perandorisë Osmane, e sidomos shqiptarët. Qëllimi ishte të kanalizonin lëvizjet çlirimtare të popujve të shtypur në lëvizjen e "përgjithshme" xhonturke. Ata përgatishnin terrenin për të ruajtur tërësinë e Perandorisë Osmane dhe pushtetin e saj të centralizuar mbi popujt e tjerë.

Ndonëse ishte në dijëni të synimeve të tyre të vërteta, ai vendosi të merrte pjesë në Kongres e të parashtronte atje, aq sa do ta lejonin mundësitë, kërkesat e shqiptarëve. Në letrën që u dërgoi krerëve xhonturq të Parisit, ai shkruante se "do të merrte pjesë në Kongres, jo si individ, por si përfaqësues i "Xhemijetit" (Shoqërisë), që është formuar në Shqipëri". Kishte parasysh Komitetin Shqiptar, i cili vepronte në Bukuresht, sepse një "Xhemijet" qendror xhonturk shqiptar nuk ekzistonte as në Shqipëri, as jashtë saj. Për këtë kërkoi nga I. Temo t'i përgatiste një akt përfaqësimi për në Kongres.¹² Përgatitja e punimeve të Kongresit xhonturk të Parisit përkoi me përpjekjet që D. Hima dhe I. Temo po bënin për të hyrë në Shqipëri.

Nga shqiptarët e emigruar, në Kongres morën pjesë Ismail Qemali, i cili atëherë ndodhej në Bruksel; Kadri Hoxha (në Kajro); Dervish Hima (në Romë) dhe Jashar Erebara, që u dërgua në emër të studentëve shqiptarë të Bukureshtit. Dervishi arriti në Paris më herët nga të tjerët, më 26 janar 1902. Në takimet që turqit e rinj organizuan në Paris në prag të Kongresit, ai njihet edhe më mirë me qëndrimin e tyre. Iu neverit mjedisi në të cilin u gjend dhe u mundua të shpëtoje prej tij. E kuptova "se qenë të këqij", i shkruante ai I. Temos më 26 janar 1902. Kongresi u mbledh në një atmosferë mosmarrëveshesh të thella, që ekzistonin jo vetëm ndërmjet xhonturqve dhe përfaqësuesve të kombeve të shtypura të Perandorisë, por edhe ndërmjet vetë krerëve të lëvizjes së turqve të rinj.

Ismail Qemali, Dervish Hima dhe shqiptarët e tjerë kundërshtuan programin centralist të A. Rizajt.¹³ Me gjithë rezervat që kishin për platformën e grupit tjetër, të princ Sabahedinit, delegatët shqiptarë, duke marrë parasysh se ajo përmbante edhe tezën mbi

decentralizimin e administratës osmane dhe mbi pjesëmarrjen e popujve joturq në drejtimin e administratës lokale, vendosën ta përkrahin atë.

Dervishi do të dëshironte të demaskonte në Kongres regjimin tiranik të Sulltanit, i cili e çonte Perandorinë Osmane e popujt e saj drejt humnerës, njëherësh aty të parashtronte kërkesat kombëtare të shqiptarëve. Por një fjalim i tillë nuk do të lejohej nga autoritetet franceze, të cilat u dhanë mundësi xhonturqve të mblidheshin në Paris, me kusht që të mos kritikonin Perandorinë Osmane dhe sulltan Abdyl Hamidin II, të konsideruar si miq të Francës. Në këto rrethana, D. Hima u kufizua vetëm me kërkesën e lirisë së gjuhës shqipe, ku për shqiptarët propozoi të drejtën e mësimit në gjuhën amtare, pavarësisht se ku jetonin.¹⁴

Hima u largua nga Kongresi i Parisit i bindur se shqiptarët nuk mund të presin asnjë të mirë nga xhonturqit, se këta nuk ndryshojnë nga osmanët që qeverisin Perandorinë. Lidhur me këtë, ai shkruante se “Unë e di fort mirë që, kur (xhonturqit-F. Sh.) të vijnë në krye të administratës, do të duan të presin nga rrënjët gjuhët e kombeve të tjera. Por të shohim se kush do t’i presë gjuhën tjetrit. Mentaliteti dhe qëllimi i këtyre njerëzve është që, nën maskën e përparimit, të ndërtojnë një Turqi tirane e të fortë. Këtë dua t’ua përplas në fytyrë në Shqipëri”.¹⁵ Dhe këtë e bëri menjëherë pas Revolucionit xhonturk.

Më 13 shkurt 1902, para se të largohej nga Parisi e të kthehej në Romë, pati një takim me Ismail Qemalin dhe princ Sabahedinin. I. Qemali dukej i gëzuar që u takua edhe njëherë me të, para se të ndaheshin. D. Hima u kumtoi bashkëbiseduesve të vet se po përpiqet për të ardhmen e popullit shqiptar, që rrezikohej më tepër se çdo komb tjetër.

Në Romë D. Hima, krahas gazetës “Albania”, botoi njërën pas tjetrës edhe dy broshura me pak faqe: “Varri i liridashësve”¹⁶ dhe “Një pasqyrë e krimeve të Sulltanit”.¹⁷ Në këto broshura ai demaskonte përsëri krimet e Abdyl Hamidit II, korrupsionin e pallatit, vrasjet e intrigat që Sulltani organizonte edhe brenda rrethit të tij, oborrit mbretëror. Qëllimi i autorit ishte t’u hapte sytë atyre shqiptarëve, të cilët e rrethonin dhe i shërbenin atij, si edhe t’u tregonte gjithë lexuesve regjimin absolut të sulltan Abdyl Hamidit.

Numrin e fundit të gazetës "Albania" e nxori në Romë, më 13 prill. Nga ky numër veçohet memorandum i krerëve shqiptarë, dërguar më 10 mars 1902 në emër të një Komiteti ekzekutiv ambasadorëve të Fuqive të Mëdha në Stamboll. Edhe këtu vihet në pah gjendja e rëndë e Shqipërisë nën zgjedhën osmane, pastaj parashtrihen kërkesat e shqiptarëve për vendosjen e një administrimi autonom, emërimin e nëpunësve shqiptarë, hapjen e shkollave shqipe etj. Në memorandum kërkohej që ambasadorët e Fuqive të Mëdha në Stamboll të ndërhynin pranë Portës për të përmbushur këto aspirata të shqiptarëve të tri besimeve, duke shprehur kështu vendosmërinë e tyre në luftën tutje për çlirimin kombëtar. "Përballë padrejtësive dhe tiranisë së Sulltanit, ata nuk shohin zgjidhje tjetër veç revolucionit të përgjakshëm që do të shpërthejë në çdo anë të Shqipërisë,¹⁸ thuhej në gazetën e tij në kryeqytetin e Italisë.

Shkrimi i dytë, po në këtë kumtar, është një letër e hapur që D. Hima i drejtoi ambasadorit osman në Romë, Reshid Beut, në të cilën i tërhiqte vëmendjen se me ndjekjet që Porta po u bënte rilindësve, ajo në fakt i kishte ndrydhur. Dervish Hima shpreh këtu besimin në fitoren e pavarësisë së Shqipërisë, duke i deklaruar ambasadorit se "ti mund të më ndalosh një ditë të nxjerr gazetë në Romë, por mos kujto se ky do të jetë fundi i përpjekjeve të mia". Ç'është e drejta, në shpalljen "Fjala e fundit në Itali", botuar po në këtë numër, D. Hima njoftonte lexuesit se për shkak të presioneve të Stambollit, qeveria italiane ndaloi nxjerrjen e mëtejshme të gazetës "Albania" në Romë. Ai do ta zhvendoste qendrën e saj në Zvicër, ku do të luftonte edhe më me ngulm kundër Sulltanit dhe për të njohur Evropën me kërkesat e ligjshme të kombit shqiptar.¹⁹

Edhe në Gjenevë, D. Hima vëmendjen kryesore ua kushtoi ngjarjeve në Shqipëri, duke mbajtur lidhje me atdhetarët që vepronin brenda vendit, duke punuar për të bërë të njohur në Evropë Lëvizjen shqiptare dhe kërkesat e saj të drejta. Lidhur me qëndresën kundërosmane të vitit 1903, e filluar me ngjarjet e Shkodrës të janarit të atij viti, D. Hima po bënte të ditur se shkodranët i dërguan Sulltanit një peticion me një mijë nënshkrime, megjithëse ai nuk jep detaje të rëndësishme për këtë ngjarje.

Ishte koha kur në shkurt të vitit 1903 rritet pakënaqësia e përgjithshme, për shkak të ndërhyrjeve të reja të Vjenës dhe Shën

Petërburgut, të cilët më 21 shkurt 1903 i paraqitën Portës projektin austro-rus të "reformave", i miratuar edhe nga Fuqitë e Mëdha, si dhe nga vetë Sulltani. Me zbatimin e këtij projekti, Fuqitë e Mëdha do të sanksiononin në fakt copëtimin e tokave shqiptare të vilajeteve të Kosovës dhe të Manastirit, të cilat ndaheshin nga ato të vilajeteve të Shkodrës e të Janinës. Kjo ishte arsyeja që shqiptarët u shprehën kundër këtij projekti. Qëndrimin e shqiptarëve ndaj të ashtuquaturave reforma maqedonase, Dervish Hima e trajtoi në një artikull të veçantë me titull "Çështja shqiptare e maqedonase dhe shembja e shtetit osman", të përgatitur për numrin e shkurtit të gazetës "Albania". Këtu ai botoi edhe një promemorie për Shqipërinë, drejtuar kryeministrit Ferit Pashë Vlora, ku demaskonte sërish regjimin tiranik të sulltan Abdyl Hamidit II, ndërsa më 25 shkurt të vitit 1903 i shkruante Temos se në pjesën frëngjisht të gazetës, ka botuar shkrimin "Reformat dhe shqiptarët e Pejës".²⁰

Ndërkaq, gjendja në Shqipëri sa vinte e acarohet dhe shqiptarët, sidomos ata të Kosovës, po kundërshtonin të gjitha përpjekjet e Portës dhe të inspektorit të përgjithshëm të Rumelisë, Hilmi Pashës, për t'i detyruar të pranonin reformat e shpallura. Në mars të vitit 1903, mijëra shqiptarë të armatosur tubohen në rrethet e Prizrenit, të Mitrovicës, në zonën e Gjakovës dhe të Pejës. Përleshje të përgjakshme ndodhën në rrethin e Mitrovicës, ku garnizoni osman, i nxitur edhe nga konsulli rus, sulmoi kryengritësit. Më shumë se 200 shqiptarë mbetën të vrarë në hyrje të Mitrovicës, ndërsa në muajin prill kundër shqiptarëve hidhen forcat e tjera, të komanduara nga gjenerali famëkeq Shemsi Pasha.²¹ Duke u bërë jehonë këtyre ngjarjeve, D. Hima shkruante në ato ditë të prillit të 1903-it se në Shqipëri po rriten turbullirat, se aty po derdhet përsëri gjak i pafajshëm dhe pa asnjë të drejtë.

Gjatë qëndrimit në Romë, në qershor të 1903-it ai u takua me I. Qemalin, që kishte shkuar atje nga Brukseli. Ky i propozoi militantit të spikatur formimin e një Komiteti të përbërë nga shqiptarë, të krishterë e muslimanë, i cili do të mblidhte nënshkrime te popullata dhe do të shkonte nëpër kabinetet evropiane për t'u parashtruar kërkesat e shqiptarëve. Hima e quajti të drejtë mendimin e tij. Ai shkruante gjithashtu se I. Qemali kishte përgatitur një hartë të Shqipërisë, të cilën do ta botonte së shpejti. Ai i kishte thënë se

“para së gjithash do të përcaktojmë kufijtë tanë...Çdo njeri duhet të njohë kufijtë e Shqipërisë”. I. Qemali i premtoi t’ia dërgonte hartën, sapo ta botonte.²²

Në Paris, D. Hima mori pjesë në një konferencë të organizuar në fillim të shkurtit të 1904-ës, me nismën e Albert Gjikes, princ rumun me prejardhje të largët shqiptare, që donte të vihej në krye të lëvizjes kombëtare shqiptare dhe, në rast sukseesi eventual, synonte fronin e Shqipërisë, duke hedhur më vonë parullën e “pavarësisë” së Shqipërisë. D. Hima nuk i përkrahte ambiciet e këtij aventurieri për t’u bërë sundimtar i Shqipërisë, ndërsa më 8 shkurt të po atij viti, i shkruante mikut të tij, I. Temos se A. Gjika meditonte të bënte një aventurë: nëse Sulltani nuk do ta pranonte atë si adjutant perandorak në Stamboll, ai do të hidhej në Shqipëri, duke më marrë edhe mua me vete. Megjithatë, Dervish Hima, duke dashur ta përdorte këtë konferencë për të mirën e çështjes shqiptare, mori pjesë në të dhe mbajti një referat politik, të cilin e botoi edhe në njërin nga numrat e “Albanisë”.

Ndikim në jetën politike të D. Himës në Paris patën edhe bisedat e tij me I. Qemalin. Më 17 prill 1904 Hima takohet me të në njërin ndër hotelet e Parisit, ku ai qëndronte zakonisht. I. Qemali i foli për veprimet e tij diplomatike në Evropë, për vizitën që kishte bërë në Itali e në Gjermani dhe për takimin me gjeneral Garibaldin, me ministrat e qeverisë italiane dhe të asaj greke. Kishte kërkuar që Roma e Athina të ndiqnin një politikë më të mençur ndaj Shqipërisë, e cila një ditë do t’u sillte dobi të dyja palëve. Qeveria greke i kishte shkëputur premtimin për të hapur një shkollë normale shqipe në Korfuz dhe për ta bërë gjuhën shqipe si gjuhë të detyrueshme në shkollat greke që funksiononin në Shqipëri.²³ D. Hima i priti me kënaqësi këto njoftime. “Po të hapet me të vërtetë një shkollë e tillë, i shkruante Temos, nuk do të jetë keq. Do të ketë jehonë anembanë Evropës... Mendimi i Ismail Qemalit lidhur me shkollat më ka ngjallur shpresa”,²⁴ shkruante ai.

Krahas veprimtarisë publicistike, gjatë viteve 1904-1908 D. Hima zhvilloi një aktivitet të gjerë diplomatik në të mirën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Artikujt e botuar në “Albania”, si edhe letrat që u shkruante miqve të vet, dëshmojnë se ai e njihte mirë situatën ndërkombëtare, marrëdhëniet dhe kundërthëniet ndërmjet Fuqive të Mëdha atëherë, si dhe monarkive ballkanike. Aftësi të veçanta

diplomatike tregoi edhe në memorandumun për çështjen shqiptare, që i dorëzoi, më 12 shtator 1904, ministrit të Serbisë në Paris, Milenko Vesniqit, për t'ia përcjellë ministrit të Jashtëm të Serbisë, Nikolla Pashiqit. Në hyrje vihej në spikamë memorandumun apo raporti, siç e quajti atë thjesht autori, që i dërgohej N. Pashiqit me kërkesën e vetë ministrit serb në Paris. Ky kishte marrë urdhër drejtpërdrejt nga Beogradi për të hyrë në kontakt me D. Himën e për t'u njohur me opinionin e tij lidhur me çështjen shqiptare. Sikurse shihet nga përmbajtja e memorandumit, N. Pashiqi në këtë rast mori përgjigje të prerë. D. Hima i kumtoi atij se as ai dhe as shqiptarët në tërësi nuk do të binin viktimë e skenarit të Pashiqit apo bashkëmendimtarëve të tjerë në Ballkan.

Që në fillim të memorandumit, autori shkruante se objekti i raportit të tij do të ishte qëndrimi i qeverive ballkanike dhe i Fuqive të tjera të interesuara ndaj çështjes shqiptare, e cila ishte bërë tepër e rëndësishme për shtetet që e rrethonin Shqipërinë. Ai vlerësonte si një faktor pozitiv bashkëpunimin e ndërsjellë dhe fqinjësinë e mirë ndërmjet shqiptarëve dhe popujve fqinj, por vinte në dukje, njëherësh, që përvoja historike dëshmonte se përpjekjet e bëra deri atëherë nga qeveritë e shteteve fqinje për t'i tërhequr shqiptarët në sferën e vet politike, kanë qenë të diktuar nga një politikë krejtësisht e gabuar. "Askush, thuhej në memorandum, nuk ka marrë, as nuk do të marrë asgjë nga ky popull, mbasi mjetet e veprimtimit janë të njolloosura me propozime korruptuese, në kurthin e të cilave shqiptarët nuk pranojnë të bien, orvatje të tilla nuk i kanë sjellë fryte as Greqisë, as Bullgarisë, as Italisë e sidomos Serbisë.²⁵

Pjesa tjetër dhe më e madhe e memorandumit i kushtohej historikut të çështjes shqiptare, duke filluar nga Lufta ruso-osmane e 1877-1878-ës, qëndrimin të shteteve evropiane ndaj Shqipërisë dhe padrejtësive që iu bënë popullit shqiptar, duke copëtuar trojet e tij më vitale. Shqiptarët u zhgënjyen rëndë nga cungimi i territoreve të tyre, të miratuara nga Evropa, dhe se ato u përdorën për të zgjeruar Malin e Zi e Serbinë që përkraheshin nga Rusia cariste. Nuk u përmbushën as shpresat e shqiptarëve për të siguruar reforma dhe bashkimin e viseve të tyre në një vilajet të vetëm, në bazë të ligjit organik, që komisioni i shteteve evropiane dhe Porta e miratuan më 1880, në përputhje me Nenin

23 të Traktatit të Berlinit. Duke prezantuar opinionin e të gjithë atdhetarëve dhe intelektualëve shqiptarë, D. Hima protestoi në këtë memorandum edhe kundër orvatjeve të reja, posaçërisht, Ruisë dhe Austro-Hungarisë, të cilat, në frymën e programit të Myrcshtegut të vitit 1903, synonin formimin e një "Maqedonije bullgare". Prandaj përfshirja e viseve shqiptare, pra të vilajeteve të Kosovës dhe të Manastirit në kuadrin e saj, si dhe shkëputja e tyre nga trangu amë, do t'i nxirrte dore Shqipërisë më shumë se gjysmën e popullsisë dhe tri të katërtat e territorit të saj, duke e ngushtuar në një vend të vogël bregdetar. "Ja, këto fakte, shkruante Hima, duke e mbyllur memorandumun, i revoltojnë ndjenjat kombëtare të shqiptarëve".²⁶

Me gjithë qëndrimin më shumë se një vjeçar në Paris, ai nuk arriti ta botonte gazetën e tij. Në mars të vitit 1905 u vendos në Bruksel, ku nisi të botonte "Albaninë" e tij më 15 janar të vitit kalendarik 1905. U botua ky kumtar në shqip, në frëngjisht dhe në turqisht, ndërsa artikulli i parë ishte me titullin "Pushim i konsullit grek dhe çështja shqiptare", botuar në frëngjisht, në të cilin D. Hima, duke marrë për motiv dëbimin e konsullit grek në Manastir me iniciativë të Portës, trajtoi në përgjithësi qëndrimin e Athinës zyrtare ndaj çështjes shqiptare. Konsulli grek u ndoq, meqë kishte qenë i lidhur me bandat greke, të cilat vepronin në viset shqiptare e maqedonase të Vilajetit të Manastirit, pohoi ai. Në sajë të presioneve të tij dhe të klerit grek u mbyll më 1902 shkolla shqipe e Korçës, që për 15 vjet i shërbeu arsimit kombëtar. D. Hima përshëndeti luftën e armatosur të çetave të kryesuara nga Bajo e Çerçiz Topulli. "U lumtë shqiptarëve tanë", i shkruante Temos më 6 tetor 1906, "që e çuan më në fund në parajsën e gomarëve mitropolitin e Korçës".²⁷ Ai u përpoq, gjithashtu, të lidhej drejtpërdrejt me B. Topullin.

Në verën e vitit 1907, ai zhvilloi një veprimtari të dendur diplomatike në të mirë të çështjes shqiptare dhe e shfrytëzoi për këtë "Konferencën e Paqes" të Hagës, e cila i zhvilloi punimet e saj në qershor-gusht të vitit 1907. Rilindësit, që tanimë e njihnin mirë politikën e Fuqive të Mëdha, të nisur edhe nga qëndrimi ndaj Shqipërisë i Konferencës së Hagës të vitit 1899, nuk do të ushqenin ndonjë shpresë për zgjidhjen e çështjes shqiptare nga ky tubim ndërkombëtar i vitit 1907. "Unë e di, shkruante D. Hima në korrik

të vitit 1907, se nga konferenca të tilla, që kthehen në maskarada, nuk do të kemi ndonjë të mirë”.²⁸

Megjithatë, si Sh. Kolonja, ashtu edhe ai, si të gjithë veprimtarët e shoqërive patriotike të mërgimit, e panë të nevojshme t’u bënë në njohur shteteve që merrnin pjesë në këtë konferencë, kërkesat e shqiptarëve. Po ai, në qershor të 1907-ës i shkruante Temos se kishte rreth dy muaj që po përgatiste një memorandum për çështjen shqiptare, të cilin mendonte t’ua dërgonte shteteve pjesëmarrëse në konferencë.

Në fillim të gushtit, D. Hima është në Hagë, ku zhvillonte punimet e saj Konferenca e Paqes. Ai shkoi atje në cilësinë gazetarit e të anëtarit të një “delegacioni” shqiptar, dërguar nga shoqëritë e Rumanisë, të Egjiptit dhe të ShBA-së.²⁹ Do t’u shpërndante përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha dhe të shteteve të tjera memorandumit të tij, të hartuar në frëngjisht dhe të paraqitur në emër të shqiptarëve të të tria besimeve.³⁰ Memorandumit e D. Himës, si edhe ato të shqiptarëve të ShBA-së, të Kolonisë së Konstancës dhe të shqiptarëve të Egjiptit, e përmend edhe konsulli austriak në Shkodër, Kral, në relacionin që i dërgonte Vjenës, më 28 gusht të vitit 1907. Po ai vinte në dukje se memorandumit i D. Himës i është dërguar Konferencës së Hagës nga shqiptarët e të tria besimeve fetare.³¹

Vetë D. Hima shkruante në letrën e 5 gushtit të 1907-ës se, përveç memorandumit të tij, i paraqiti Konferencës së Hagës edhe tri memorandume të tjera: njeri i nënshkruar nga kryetarët e shoqërive shqiptare të ShBA, hartuar në Boston, më 8 korrik 1907, një tjetër dërguar në emër të shqiptarëve të Konstancës në gusht të 1907-ës, dhe një i tretë, dërguar nga “Komiteti i kolonisë shqiptare të Egjiptit”, po në gusht të vitit 1907.³²

Në memorandumit të tij thuhet se “shqiptarët nuk ju drejtohen juve si të mundur dhe si lutës të përulur”. Jo! Ata protestonin kundër politikës së padrejtë pushtuese që ndiqnin Fuqitë e Mëdha ndaj popullit shqiptar dhe popujve të shtypur që luftonin për lirinë e tyre. Janë krejt të paligjshme veprimet e Fuqive të Mëdha, të cilat, “duke dashur të mbajnë një ekuilibër të pasigurt të shteteve evropiane”, u japin të drejtë shtypësve dhe i ndihmojnë të ruajnë pushtimet e tyre. Populli shqiptar si të gjithë popujt e Lindjes jeton në ankth dhe në pritje. Ai nuk mund të pajtohet me sovranët

që i janë imponuar e që ai i urren, të cilët e kanë ndarë territorin shqiptar si plaçkë lufte dhe si pre, ndërmjet gjithë popujve fqinj,³³ bënte të ditur ai.

Në memorandum, përveç të drejtës për hapjen e shkollave shqipe, kërkoheshin “reforma të gjera administrative”, vendosja e “një administrate autonome, e denjë për një popull të qytetëruar”, e cila do të hidhte themelet e shtetit autonom e kombëtar shqiptar. “Ne kërkojmë të drejtën për qytetërim, shkruante D. Hima. - Ne duam... të thyejmë lëvozhgën që na shtrëngon, me një fjalë duam të jetojmë. Mos do të na mohoni këtë të drejtë? Mos do ta quani veten të paaftë për të na ndihmuar? Atëherë popujt e qytetëruar do të kenë të drejtën t’ju pyesin se përse e keni marrë mundin të mblidheni dhe cili është qëllimi i seancave tuaja solemne!”³⁴

D. Hima, nuk la pa hartuar edhe rritjen e aktivitetit të xhonturqve në emigracion dhe brenda Perandorisë, sidomos në Shqipëri e në Turqinë evropiane në tërësi. Ndonëse i vlerësoi këto rrethana të reja, të jashtme e të brendshme, që u krijuan për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në pranverën e vitit 1908, ai nuk e lidhi të ardhmen e saj me asnjërën prej tyre. Nuk mund ta pranonte mendimin që pas rrëzimit të Sulltanit xhonturqit të vendosnin sundimin e tyre mbi Shqipërinë dhe gjithë Rumelinë. Në rrethanat e reja që u krijuan për Shqipërinë në pranverën e vitit 1908, ai vendosi përfundimisht të hynte në Shqipëri, ku do t’i kushtoj kryengritjes së armatosur antiosmane. Dhe, për këtë, bëri përgatitjet e nevojshme. Kishte ndërmend të futej në Shqipëri rreth 28 korrikut, fshehurazi nga ndonjë pikë e bregdetit.³⁵ Revolucioni xhonturk dhe shpallja e Kushtetutës, më 23 korrik 1908, i dha mundësi atij të kthehej legalisht në Shqipëri.

Përfundimi

Nga sa u përmend më sipër, Ibrahim Naxhi Spahiu, i njohur më mirë me emrin Dervish Hima, me invencionin (dhuntinë) e logjikën e thellë prej një njohësi të mirë rrethanash politike në Ballkan dhe brenda Perandorisë Osmane, ishte ai, i cili mbeti njëri ndër kuadrot më të spikatur të mendimit politik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

I rritur dhe i edukuar në frymën patriotike, ai mbeti forca lëvizëse e kolonisë shqiptare në mërgim, para së gjithash në Rumani, si dhe bashkëpunëtor i Ibrahim Temos, Nikolla Naços, Jashar Erebarës dhe të një varg militantësh të shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ndërkaq, në fushën e autorësisë së shkrimeve, Dervish Hima spikat erudicionin e vet me botimin e gazetës “Albania” në Romë, ndërsa në qarqet tejbalkanike do të bëhet i njohur si autor i memorandumeve drejtuar Fuqive të Mëdha, si dhe njëri ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë të Ismail Qemalit. Si i tillë, ai zë vend të merituar në ngjarjet revolucionare në Shqipëri, menjëherë pas vitit 1908.

Shënime:

¹ Historia e popullit shqiptar II, Tiranë 2002, 259.

² Po aty, 262.

³ Arkivi Qendëror i Shqipërisë, Fondi 19, dosja 12.

⁴ Po aty.

⁵ Po aty, Fondi 12, Veprimtaria krijuese.

⁶ Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, (Përgatitur nga S.Pollo dhe S.Pulaha), Tiranë 1978, dok.77, 78.

⁷ HHStA, PA, A, Informacion i konsullit austriak në Manastir, Kral, viti 1904.

⁸ “Shqipëria e re”, Konstancë, 19 gusht 1928, Dervish Hima.

⁹ “Shqipëria”, Bukuresht nr. 13, 2 gusht 1897, Një kartë.

¹⁰ “Shqipëria e Re”, Konstancë, 19 gusht 1928.

¹¹ “Albania”, Bruksel viti II, 1 tetor-dhjetor 1898, nr. 9, “Kongresi shqiptar”.

¹² Po aty.

¹³ Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1984, 410.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ AQSH, Fondi nr. 12, dosja 9, 8-9.

¹⁶ Kristaq Prifti, Dervish Hima, Tiranë 1987, 106.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ “Albania”, Romë viti II, 13 prill 1902.

¹⁹ Po aty.

- ²⁰ AQSH, Fondi 19, dosja 32/3, 249-253.
- ²¹ Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1984, 358.
- ²² AQSH, Fondi 19, dosja 32/3, 269-270.
- ²³ Po aty, 312-313.
- ²⁴ Po aty, 315.
- ²⁵ Memorandumi i D.Himës për çështjen shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XIX, "Gjurmime Albanologjike", Seria e Shkencave Historike III, 1973, Prishtinë 1975, 207.
- ²⁶ Po aty, 211-212.
- ²⁷ AQSH, Fondi 19, Dosja 32/3, 378-381.
- ²⁸ Po aty, 399-400.
- ²⁹ "Korça", 24 dhjetor 1908, nr. 10, 3.
- ³⁰ Për herë të parë memorandumi i D.Himës është botuar prej tij në gazetën "Albania" të Brukselit, në frëngjisht. Bashkë me të janë botuar edhe memorandumi i shqiptarëve të Konstancës dhe ai i Komitetit të kolonisë shqiptare të Egjiptit. (Shih: "Drita", Sofje 14 gusht 1907, nr. 97, 2. Ky memorandum botohet më vonë në gazetën "Kombi" (Boston 16 gusht 1907) në frëngjisht, si edhe në gazetën "Shpnesa e Shqypnisë" (Trieste, 30 shtator 1907) po në frëngjisht. (Shih: Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, Tiranë 1978, dok. 104, 172-175).
- ³¹ HHStA, PA A, Shkodër 28 gusht 1907, nr. 96.
- ³² Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, Tiranë 1978, dok. 103, 168-179, dok. 105, 176-177 dhe dok. 106, 177-178.
- ³³ Po aty, 172-173.
- ³⁴ Po aty, 174.
- ³⁵ Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1984, 408-409, 415-416.